

BUXHETIMI GJINOR, SFIDË PËR INSTITUCIONET



Nga Express 15 Nëntor 2012 13:08

Ndarja e drejtë e buxheteve komunale trajtohet si një çështje e rëndësishme në shtytjen e proceseve sociale, ekonomike dhe demokratike në Kosovë. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor është qasje e re për ta luftuar pabarazinë gjinore dhe për t'i plotësuar si duhet nevojat e burrave dhe grave duke reflektuar në politikat publike. Kështu u tha në konferencën ndërkombëtare “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor - Praktikë dhe Sfidat”, të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe e mbështetur nga USAID-i, DEMI, LOGOS-i, GIZ-i dhe Sida.

Edona Hajrullahu, kryeshefe e Agjencisë për Barazi Gjinore, pranë zyrës së kryeministrit, ka deklaruar se buxhetimi gjinor është një koncept relativisht i ri jo vetëm për vendin tonë po ashtu edhe për të gjitha vendet e rajonit, prandaj ka kërkuar që institucionet relevante të punojnë në atë drejtim që ky koncept i ri të bëhet realitet edhe në Kosovë.

“Një nga sfidat në vendet në tranzicion siç është edhe Kosova është edhe qasja shtetit ndaj barazisë gjinore. Në shumë shtete ku perspektiva gjinore është e integruar në politikat publike tashmë ekziston buxhetimi gjinorë. Një praktikë që në demokracitë e avancuara dhe me traditë institucionale ka vite që aplikohet. E kjo praktikë e buxhetimit shpresojmë që së shpejti do të aplikohet edhe në Kosovë”, ka thënë ajo.

Zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, me këtë rast ka thënë se të drejtat e grave dhe avancimi i pozitës së gruas në shoqërinë tonë është çështje e rëndësishme për të cilën tha se është e përkushtuar edhe si zëvendëskryeministre, por edhe si qytetare e Kosovës, që barazia gjinore të respektohet si e drejtë demokratike.

“Shoqëria jonë do të shkojë përpara në një rrugë dhe zhvillim të qëndrueshëm kur barazia gjinore të respektohet si e drejtë demokratike. Barazia gjinore është vlerë dhe e drejtë thelbësore e shoqërive demokratike, e garantuar me legjislacionin në fuqi që synon trajtim të barabartë përfshirjen në perspektivën gjinore, ndërmarrjen e masave të nevojshme për avancimin e pozitës së gruas dhe krijimin e politikave pro gjinore të cilat bëhen relative vetëm kur përkthehen në veprime konkrete përmes buxhetimit të drejtë gjinorë”, ka thënë ajo.

Tanya Urgueta, drejtoreshë për demokraci dhe qeverisje e USAID-it, misioni në Kosovë, ka shprehur vullnetin e institucionit që ajo drejton për të avancuar edhe më tutje barazinë

gjinore në Kosovë.

“Ambasada amerikane dhe shoqatat tjera do të bashkëpunojnë ngushtë me ju me qëllim që të sigurohet një barazi mes meshkujve dhe grave në pushtetin qendror dhe atë lokal. Ne së bashku kemi organizuar tryeza të rrumbullakëta për qeverisjen dhe çështjen e grave dhe kemi formuar edhe grupet e grave brenda komunës suaj dhe do të vazhdojmë të përkrahim edhe sa i përket buxhetimit”, ka thënë ajo.

Në këtë konferencë, po ashtu, u tha se Republika e Kosovës vitet e fundit ka punuar intensivisht në instalimin e politikave dhe programeve që promovojnë barazi gjinore, në mënyrë që ky parim dhe e drejtë thelbësore të reflektojë në kulturë shoqërore.

Përveç ligjit për barazi gjinore si dhe ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, u tha se janë miratuar një sërë aktesh nënligjore për fuqizimin e pozitës së gruas në shoqërinë tonë dhe njëkohësisht janë realizuar shumë fushata vetëdijësuese.

Agjencia për Barazi Gjinore tashmë ka marrë iniciativën që në kuadër të ligjit për barazi gjinore që është duke u amendamentuar të përfshihet edhe neni përmes së cilit institucionet qendrore dhe lokale gjatë planifikimit dhe ndarjes së buxhetit, të kenë për bazë një menaxhim të barabartë të financave, publike, në mënyrë që si burrat ashtu edhe gratë të përfitojnë në mënyrë të njëjtë nga buxheti shtetëror.

Në këtë konferencë u prezantuan disa praktika të buxhetimit gjinor, strategjitë, praktikat dhe sfidat që ato vende i kanë përcjellë gjatë aplikimit të këtij koncepti.